



Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivered	21.08.2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHCK	5763/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.935/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.935/2023 të datës 07.07.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rr. "Hyzri Talla" Nr.2 objekti 16 Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", kundër organit të punësimit/Agjencia e Pyjore e Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.935/2023 e datës 07.07.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. OBLIGOHET Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti" në Drejtorin e Inspektoratit Qendror të Pyltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës sipas Akt Emërimit ZPD:279/2013 të datës 31.12.2013 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Arsyetim

Ankuesi [REDACTED] i punësuar në vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Koncesion" në DKR të Agjencinë Pyjor të Kosovës në Ferizaj sipas vendimit për transferimin e nëpunësit civil, transferim i përhershëm me numër Ref: KE-09/19 të datës 09.01.2019. Me datë 02.06.2023 me numër protokoll 2170 ka bërë kërkesë për kthimin në vendin e punës si "Inspektor i Pylltarisë dhe Gjuetisë" sipas Akt Emërimit të datë 13.12.2013 dhe shuarjes së masës disiplinore tek Zëvendës Drejtori Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Ndërsa me datë 15.06.2023 me numër protokoll 2450 institucioni i ka kthyer përgjigje me arsyetimin se pas analizimit të vendimit për transferin e NC vendimi për Transfer të Përhershëm me numër Ref: KE-09/19 datë 09.01.2019 nga pozita "Inspektor i Pylltarisë" në pozitën "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Koncesion" vendimi është nxjerr bazuar në vendimin e Komisionit Disiplinor me NP-325/2018 datë 21.12.2018 dhe nga ajo që shihet në vendimin për transfer bëhet fjalë për Transfer të Përhershëm bazuar në dispozitat ligjore në fuqi të asaj kohe. Përveç kësaj bazuar në nenin 71 të Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2023 Inspektorati i Pylltarisë funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural andaj lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen sipas kërkesës suaj mbetet kompetent MBPZHR po ashtu duke pasur parasysh faktin se ligji për inspektive sa i takon funksionimit të inspektorateve qendrore parasheh që të njëjtit veprojnë në kuadër të Ministrisë.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e datës 15.06.2023 me numër protokoll 2450 të Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ka parashtruar ankesë me datë 07.07.2023 me numër protokoll 5095/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Zëvendës Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës ka kthyer përgjigje jo të bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, i njëjti kërkon që të kthehet në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 31.12.2013, pas shuarjes së masës disiplinore me numër Ref.SBNJD-63/2023 të datës 14.07.2023 ndaj tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore e Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 27.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Pyjore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokoll 5095/2023 të datës 07.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 02.06.2023 me numër protokoll 2170 për kthimin në vendin e punës si "Inspektor i Pylltarisë dhe Gjuetisë" sipas Akt Emërimit të datës 13.12.2013 dhe shuarjes së masës disiplinore; Përgjigjeja me numër protokoll 2450 e datës 15.06.2023 e Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës; Vendim i Komisionit Disiplinor në Agjencinë Pyjore të Kosovës me numër protokoll 3390 i datës 21.12.2018; Akt Emërim i N.K. me numër ZPD:279/20013 i datës 31.12.2013; Vendim i KPMSCHK me numër protokoll 2008/2021 i datës 26.04.2021; Njoftim me numër protokoll 1776 i datës 02.05.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 19.07.2023; E-mail nga C.Z. për D.G. i datës 19.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 27.07.2023; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Lartë



për Planifikim shfrytëzim dhe Koncesionim" i datës 15.06.2012; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Inspektor i Pylltarisë" i datës 15.06.2012; Vendim për transferimin e nëpunësit civil, transferim i përhershëm me numër Ref: KE-09/19 të datës 09.01.2019; Deklaratë me numër Ref.SBNJD-63/2023 i datës 14.07.2023; Pliko me numër R5222846 i datës 27.07.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar, sepse:

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi [redacted] sipas vendimit me numër Ref.SBNJD-325/2018 të datës 20.12.2018 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës sipas pozitës "Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti" në Drejtoratin e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë është shpallë përgjegjës për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës dhe i është shqiptuar masa disiplinore sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në nenin 66 paragrafin 4 nën paragrafin 4.2 largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor dhe nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil 1. për shkelje të rënda serioze të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje, nëpunësit civil mund ti shqiptohen këto masa, 1.3 largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor.

Ndërsa Agjencia Pyjore e Kosovës ka nxjerr vendim me numër Ref.KE-09/2019 të datës 09.01.2019 për transferimin e nëpunësit civil, transferim i përhershëm i z. [redacted] "Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti" në Drejtoratin e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë me punë dhe detyra të ngjashme profesionale konform masës disiplinore të shqiptuar nga Komisionit Disiplinor i APK në pozitën dhe vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Koncesion" në DKR të Agjencinë Pyjor të Kosovës në Ferizaj.

Meqenëse ankuesi pas kalimit të afatit të masës disiplinore nuk është kthyer në vendin e tij të punës, edhe pse me datë 02.06.2023 ka parashtruar kërkesë, atëherë sipas ankesës së ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i njëjti kërkon që të kthehet në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 31.12.2013, pas shuarjes së masës disiplinore me numër Ref.SBNJD-63/2023 të datës 14.07.2023 ndaj tij.

Fillimisht Përgjigjëja me numër protokoll 2450 e datës 15.06.2023 e Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, për ankuesin nuk përmban këshillë juridike se ku pala ka të drejtë të përdorë mjetet juridike të tij, atëherë mbi bazë të kësaj rrethane të LPPA-së përcaktohet: 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashkuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. siç përcaktohet me nenin 127 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mbi këtë bazë edhe ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill është e afatshme në kuptim të nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të këtij ligji.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit masa disiplinore *largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor*, i është shqiptuar me datë 21.12.2018 ndërsa me qëllim të zbatimit të Vendimit Ref.SBNJD-325/2018 të datës 20.12.2018 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ankuesi në bazë të vendimit me numër Ref.KE-09/2019 të datës 09.01.2019 për transferimin e nëpunësit civil, transferim i përhershëm i z. [REDAKTUAR]

*“Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti”* në Drejtorin e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë me punë dhe detyra të ngjashme profesionale konform masës disiplinore të shqiptuar nga Komisionit Disiplinor i APK në pozitën dhe vendin e punës *“Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Koncesion”* në DKR të Agjencinë Pyjor të Kosovës në Ferizaj. Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kthim në vendin e punës pas kalimit të afatit të masës disiplinore. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave meqenëse konstaton se në bazë të Deklaratës së lëshuar nga Njësia e Personelit të Agjencisë Pyjore të Kosovës me numër Ref.SBNJD-63/2023 të datës 14.07.2023 është shuar masa disiplinore e ankuesit, rrjedhimisht pas kalimit të afatit të vlefshmërisë të masës disiplinore pasi që e njëjta është konsumuar, atëherë institucioni respektivisht Agjencia Pyjore të Kosovës ka qenë e obliguar që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës sipas kërkesës së tij, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryeshefi Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës është i obliguar që ankuesin [REDAKTUAR] ta kthejë në vendin e tij të punës *“Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti”* në Drejtorin e Inspektoratit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës sipas Akt Emërimit ZPD:279/2013 të datës 31.12.2013 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda A.nr.935/2023

Çlirim ZEKA  
  
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.